

## **NJOFTIM PER VEND VAKANT PER KOORDINATOR PER ASISTENCEN NDAJ SUBJEKTEVE ME STATUS TE POSACEM**

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare **Pogradec**, kerkon te punesoje 1 (nje) punonjes ne administrate me detyre Koordinator per asistencen ndaj subjekteve me status te posaçem.

### **Pershkrimi i punes:**

Pergjegjesite kryesore:

Punonjesi permbush detyrimet e prokurorise per informacion ndaj viktimave dhe deshmitareve, referimin e viktimave tek ofruesit e sherbimeve dhe garantimin e mundesive per ushtrimin efektiv te te drejtave te tyre. Punonjesi ndihmon çdo pjesemarres ne procedim qe ka nje paaftesi fizike apo mendore per te ushtruar me efektivitet te drejten per akses ne sistemin e drejtesise penale.

### **Funksionet kryesore:**

- a) Ofron sherbime dhe keshilla per viktimat e krimit, ne veçanti per ato te kategorive si vijon: te miturit, viktimat e dhunes ne familje, abuzimit seksual dhe pemdjekjes, viktimat e trafikimit te qenieve njerezore dhe viktimat me paaftesi fizike dhe intelektuale, duke pasur parasysh moshen dhe situaten specifike.
- b) U shpjegon viktimave procesin e drejtesise penale dhe procedurat e ndryshme gjyqesore.
- c) Merr informacion, siguron mbeshtetje emocionale dhe nderhyrje ne rastet e krizes si dhe ben referime tek ofruesit shteteror dhe ato jofitimprures te sherbimeve.
- d) Sherben si nderlidhes ndermjet Prokurorit te rastit dhe viktimes.
- e) Kryen detyrat nen drejtimin e Prokurorit te çeshtjes dhe brenda kufijve te sekretit hetimor. Ne rast mosperputhjesh i raporton ato tek Prokurori i çeshtjes.
- f) Mban kontakt me viktimen dhe deshmitarin gjate fazave te procedimit penal, duke dhene mbeshtetje emocionale dhe informacion praktik, sipas nevojës.
- g) Vepron si nderlidhes me agjensite e arsimit dhe sherbimet sociale ne komunitet.
- h) Krijon dosje te rasteve, sipas udhezimeve te marra nga Drejtuesi i Prokurorise.
- i) Perditeson rregullisht udhezimet, politikat dhe procedurat standarde te operimit te nxjerra nga Prokurori i Pergjithshem
- j) Kryen detyra te tjera qe i caktohen nga Prokurori apo Drejtuesi i Prokurorise

### **Kushtet e pergjithshme:**

- a) te jetë shtetas shqiptar
- b) te ketë zotësi te plote për të vepruar;
- c) te zoteroje gjuhen shqipe, te shkruar dhe te folur;
- d) te jete ne kushte shendetesore qe e lejojne te kryeje detyren perkatese;

- e) te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje kundervajtjeje penale me dashje si dhe te mos jete nen hetim;
- f) ndaj tij te mos jete marre masa disiplinore e largimit nga sherbimi civil, qe nuk eshte shuar sipas ligjit;
- g) te kete perfunduar ciklin e dyte te studimeve universitare per psikologji, sociologji, ose fusha te tjera te ngjashme.

**Kushtet e posaçme:**

- a) Te kete aftesi per te krijuar marredhenie pune efektive me stafin e Prokurorise, ofruesit e sherbimeve qe operojne ne komunitet, viktimat dhe publikun.
- b) Te kete aftesi per te ndervepruar ne menyre efektive dhe me takt me viktimat emocionalisht te shqetesuara.
- c) Te ruaje sekretin hetimor.
- d) Te ruaje konfidencialitetin e informacionit te viktimes.
- e) Te kete integritet dhe cilesi te larta morale.
- f) Te marre pjese ne trajnime te vazhdueshme ne lidhje me viktimat e kimit.
- g) Te kete njohuri te mira kompjuterike te tilla si: Microsoft Word, Excel, Power Point, etj.
- h) Te kete njohuri te gjuheve te huaja

**Kritere te preferuara, por jo te nevojshme:**

- a) Njohja e sherbimeve qe u ofrohen viktimave te kimit nga ofrues te ndryshem shteterore dhe jo qeveritare.
- b) Njohja e sistemit te drejtesise penale dhe procedurave gjyqesore.

Personat e interesuar duhet te paraqesin ne Prokurorine prane Gjykates se shkalles se pare Pogradec, deri ne daten **04.05.2021** ora 16.00, keto dokumenta:

- a) Kerkese per punesim,
- b) Fotokopje e leternjofimit/kartes se identitetit/pasaporte.
- c) CV (Jeteshkrim) te detajuar se bashku me nje foto.
- d) Diplome e shkolles se larte, master, çertifikate notash dhe çdo diplome tjeter qe tregon specializimin ne fushen e caktuar.
- e) Dëshmi penaliteti.
- f) Vertetim nga Gjykata dhe Prokuroria qe nuk ndiqet penalisht.
- g) Fotokopje te librezes se punes ose vertetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore qe te provoje punesimin e meparshem ose vertetim nga qendra e meparshme e punes, ku te evidentohet pozicioni i punes dhe kohezgjatja.
- h) Vertetim vendbanimi.
- i) Vertetim mjekesor per gjendjen shendetesore.

***Të gjithë dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë ose origjinale, ose fotokopje e noterizuar.***

Pranimi i dokumentacionit te dorezuar nga kandidatet do te behet ne Kryesekretarine e Prokurorise prane Gjykates se shkalles se pare Pogradec, **deri ne daten 04.05.2021 ora 16.00 duke konfirmuar marrjen ne dorezim sipas inventarit te akteve te dorezuara.**

Verifikimi paraprak i kandidateve do te behet nga Kryesekretarja e kesaj Prokurorie, e cila pasi te marre praktikat dokumentare per secilin kandidat duhet te verifikoje nese kandidatet kane plotesuar kushtet e pergjithshme dhe të veçanta.

Vleresimi i kandidateve nga Komisioni i Pranimi do te behet bazuar ne dokumentacionin e secilit kandidat si dhe rezultatit te intervistes me secilin prej tyre. Intervista me secilin kandidat, do te kryhet ne ambientet e Prokurorise prane Gjykates se shkalles se pare Pogradec, **ne date 06.05.2021, nga ora 12.00 deri ne oren 14.00.** Njoftimi i dates se intervistimit per kandidatet e kualifikuar do te behet me telefon ose e-mail nga Kryesekretaria.

Per çdo sqarim mund te kontaktoni ne numrin 0832 22338, ose vizitoni faqen e internetit [www.pp.gov.al](http://www.pp.gov.al).

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NE PROKURORINË  
PRANË GJYKATES SË RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC**